


REPUBLIKA E KOSOVËS - RIKUVA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO ШЕРАТ ШТАМИНИСТРИ-ОФИЦИЈА МИНИСТРА - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Numri i Dokumentit Doc. No.	01
Seria Doc. Ser.	1059/16
Nr. i Dokumentit No. i Dokumentit	- PO -
Data Datum Date	10 / 04 / 20 18
Prishine / a	



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria-Vlada-Government  
 Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health

RAPORTI I PUNËS TREMUJORE

Zëvendësministri, Dr. Rrustem Musa

Që nga emërimi im në pozitën e zëvendësministrit në Ministrinë e Shëndetësisë, fokusi im ka qenë ndihma në zbatimin e ligjshmërisë dhe funksionimin normal të institucioneve shëndetësore në Republikën e Kosovës. Pra, nëpërmjet punës sime që të arrijë krijimin e parakushteve për ofrimin e shërbimeve cilësore në fushën e shëndetësisë për gjithë qytetarët, por edhe për përmirësimin e kushteve për punë të punëtorëve shëndetësorë.

Më 20.01.2018, nga ana e ministrit jam ngarkuar që ta udhëheq grupin, i cili, fillimisht në mënyrë të saktë do të evidentojë numrin e specializantëve, të cilët nuk mbështetën financiarisht me paga nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, përfshirë kohën e fillimit dhe të përfundimit të specializimeve. Raporti ka nxjerrë përfundimin se, 545 mjekë në specializime janë pa pagë fare. Sipas llogarisë, kostoja që do të mbulonte këto paga, për vitin 2018, i kushton buxhetit të shtetit, 2,941,060.00€, të cilat do të siguroheshin nga subvencionet.

Nr i përgjithshëm 545

Periudha	Nr i spec.	Pagesa për muaj	Totali
Janar-Dhjetor 2018	458	479	2,632,584.00
Janar -Qershor	47	479	135,078.00
Janar-Korrik	17	479	57,001.00
Janar-Tetor	10	479	47,900.00
Janar-Nëntor	13	479	68,497.00
<b>Totali</b>			<b>2,941,060.00</b>

Pas fillimit të grevës nga ana e mjekëve specialistë, në disa klinika në SHSKUK, me kërkesën për rritjen e koeficientit në 11, nga ana e ministrit jam ngarkuar që të bisedoj dhe t'i bind që ta ndërpresin grevën, gjë që ia kam arritur, kështu që të gjithë kanë pranuar t'i kthehen punës me kusht që tani e tutje të ketë një trajtim më dinjitoz të mjekëve, në veçanti me Ligjin për Paga, i cili pritet të aprovohet.

Po ashtu, nga ministri jam ngarkuar që të hulumtoj dhe të gjej ligjshmërinë e pagesës së kujdestarive për mjekët, sepse në këtë drejtim konsiderohet padrejtësi, pasi që rritja e pagave që ka ndodhur nuk është paraparë edhe në rritjen për kujdestarinë, e që është në kundërshtim me ligjin.

Si anëtar i Këshillit Nacional për Shëndetësi dhe Siguri në Punë, për herë të parë jemi takuar më 16.02.2018, me ç'rast jemi pajtuar që ta kemi një plan të punës.

Më 2.03.2018, si anëtar i Këshillit Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, vizituam Institutin e Shëndetësisë së Punës në Obiliq, i cili funksionon si shoqëri aksionare, me Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, që është në kuadër të SHSKUK-së.

Gjatë vizitës u njoftuam nga afër me punën dhe veprimtarinë e tyre, përfshirë edhe problemet, me të cilat ballafaqohen gjatë funksionimit të tyre.

Ne si këshill kemi dalë me këto rekomandime:

- Instituti i Mjekësisë së Punës në Obiliq, nuk mund të funksionojë si shoqëri aksionare, andaj duhet shikuar mundësinë që të jetë pjesë përbërëse e SHSKUK, e për këtë të themelohet një komision i veçantë nga Qeveria, i cili kishte për të shqyrtuar kërkesat e tyre.

- Bazuar në rëndësinë e këtyre instituteve për shëndetin e popullatës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë të ndajë specializime nga lëmia e shëndetësisë së punës dhe të emërojë një komision ekspertësh, i cili do të përpilojë listën e sëmundjeve profesionale, dhe të njëjtën ta dërgojë në Qeverinë e Kosovës për aprovim.

Duke parë numrin e madh të insulteve Cerebovaskulare, vdekshmërinë e madhe të shkaktuar nga ICV, pasojat që lënë tek të mbijetuarit, qoftë në hendikepin shëndetësor, por edhe paaftësinë për punë, bazuar edhe në ngarkesën buxhetore për shtetin, i kam propozuar ministrit që, për herë të parë në Kosovë të fillojmë me Stroc IUNIT në kuadër të Klinikës së Neurologjisë, ku, fillimisht do të bëhet trajtimi medikamentozë IICV, për çka jam ngarkuar që të udhëheq punët dhe bazuar në dinamikën e punëve, më së largu 2-3 muaj, ky trajtim të fillojë të funksionojë në qendër.

Dihet se njerëzit me nevoja të veçanta janë kategoria më e ndjeshme e shoqërisë, përfshirë edhe invalidët civil të luftës dhe jo vetëm këta. Mbi të gjitha prioritet ynë ishte trajtimi i atyre që kishin nevojë për proteza. Me këtë detyrë isha ngarkuar edhe në fund të mandatit të kaluar si zëvendësministër. Pra, detyra ime është, përveç të tjerash të kam kontakte me kategoritë e lartcekura dhe të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për përkrahjen e tyre.

Në këtë drejtim nuk kanë munguar rezultatet. Trajtimi i tyre, në veçanti i rasteve urgjente është realizuar edhe nëpërmjet fondit për trajtim jashtë vendit, por kemi qenë të fokusuar në funksionalizimin e plotë të Qendrës Ortoprotetike në kuadër të SHSKUK-së duke e pajisur me mjete të nevojshme për punimin e protezave.

Gjatë punës sonë, Ministrisë së Arsimit i kemi propozuar një draft memorandum, që mjetet e Ortoprotetikës, nga Qendra e Kompetencës në Ferizaj, të cilat janë shumë moderne, t'i dhurohen Ortoprotetikës në SHSKUKU, e që do të ishin të mjaftueshme për kompletimin me pajisje pune në këtë qendër. Përveç kësaj nevojitet një përkrahje financiare nga Qeveria e Kosovës, me ç'rast kostoja e trajtimit do të ishte shumë më e ulët për shtetin se sa deri më tani që janë trajtuar jashtë institucioneve publike.

Fatkeqësisht, spitali i Mitrovicës akoma po i vuan pasojat e ndarjes së qytetit në dy komuna, pra mbetjes së objekteve të spitaleve në pjesën veriore, andaj me qëllim të funksionalizimit sa më efikas duhet përkrahje e vazhdueshme, në veçanti është kërkesë urgjente funksionalizimi i Repartit të Pediatriës.

Dihet se Shoqata Humanitare "Nëna Terezë" nga Gjermania ka investuar në ndërtimin e objektit, por në mungesë të mjeteve, për çka është deklaruar shoqata, punët nuk janë finalizuar si: rregullimi i enterierit të brendshëm, përfshirë edhe pajisjet mjekësore. Në kontakt me drejtuesit e shoqatës, SHSKUK dhe Spitali i Mitrovicës kemi vendosur që të bëhet një prerje ndërmjet punëve të kryera dhe atyre të pakryera, gjë që shoqata e ka raportin, por duhet ta ketë edhe ministria, pastaj të shikohet se çka është e domosdoshme që të investohet për funksionalizimin e Repartit të Pediatriës, në mënyrë që fëmijët e këtij regjioni të trajtohen në Spitalin e Mitrovicës, pa patur nevojë të dërgohen në QKUK, apo dikund tjetër.

Në këtë drejtim është bërë vlerësimi për nevojat financiare për këtë projekt. Jemi në kontakte të vazhdueshme me të gjithë akterët që ky projekt të finalizohet sa më parë. Përvoja ime shumëvjeçare në QKUK më ka bërë të mundur që të kemi shumë takime me menaxhmentin dhe me të gjitha profesionet në këtë institucion, gjë që kjo më ndihmon që SHSKUK-në si dhe gjithë shëndetësinë kosovare ta nxjerrim nga kriza në të cilën ndodhet aktualisht.

Edhe pjesëmarrja ime në takimet e KES-it, ku jam zëvendës, zëvendësimi i ministrit në shumë takime në mbledhjet e Qeverisë dhe pjesëmarrja në shumë prezantime në fushën e shëndetësisë më kanë pajisur me një përvojë të mirë, të cilën do ta shfrytëzoj për realizimin e objektivave të mia dhe detyrave që më ngarkohen.

*Prishtinë*  
*10.04.2018*

*Zëvendësministri në Ministrinë e Shëndetësisë*  
*Dr. Rrustem Musa*

